

Njoftim per konsultim publik
Bashkia Korçë/Këshilli i Bashkisë Korçë,

Titulli: Miratimi i planeve të mbarështimit për ekonomitë pyjore Panarit – Treskë”, “Përparimaj – Dardhë”, “Voskopojë”, “Voskopojë 2”, “Zëmlak – Qarr” dhe ekonomisë kullimore “Rungajë”.

Propozuesi: Projekt aktet janë propozuar nga Ekzekutivi/Kryetari i Bashkisë, Z. Sotirajq Filo

Sqarime për projekt aktin: Relacioni sqarues i projekt aktit përcakton arsyet e paraqitura nga propozuesi i projekt aktit të cilat në mënyrë të përmbledhur janë:

Me financim nga Banka Botërore, e kontraktuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit e cila ka kontraktuar kompanitë Abkons dhe Oikon Croatia të cilat janë shpallur fituese për përgatitjen e disa planeve të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave të Bashkisë Korçë, të cilat janë selektuar nga Sektori i Pyjeve, aktualisht Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave, janë përgatitur gjashtë plane mbarështimi të ekonomive pyjore “Panarit – Treskë”, “Përparimaj – Dardhë”, “Voskopojë”, “Voskopojë 2”, “Zëmlak – Qarr” dhe ekonomisë kullimore “Rungajë”.

Pas realizimit planet e mbarështimit të ekonomive pyjore dhe kullimore janë dorëzuar nga ana e kompanisë “Abkons dhe Oikon Croatia, në Bashkinë Korçë. Kërkohet miratimi nga Këshilli Bashkiak i këtyre planeve.

Kalendari i konsultimit: Konsultimi publik do te realizohet në:

- 18.06.2024 vendi Nj.Administrative Vithkuq ora 17:00
- 19.06.2024 vendi Nj.Administrative Mollaj ora 17:00
- 19.06.2024vendi Nj.Administrative Drenovë ora 15:00
- 20.06.2024 vendi Nj.Administrative Voskopojë ora 15:00

Banorët do të kenë mundësi të konsultojnë dokumentat në lidhje me çështjet për diskutim në linkun e mëposhtëm:

<https://bashkiakorçe.gov.al/files4users/files/20240522132007925.pdf>

Pjesëmarrës:

- **Nga ana e Bashkisë dhe e këshillit bashkiak:** Këshilltare te KB, anëtarë të Komisionit të Buqësisë, Pyjeve, Menaxhimit të Ujërave, Mbrojtjes të Mjedisit dhe Biodiversiteit, sekretari i KB, përfaqësues të administratës, koordinatori për konsultimin publik në bashki.
- **Nga komuniteti:** Banorët e fshatrave pranë ekonomive pyjore Panarit, Treskë, Përparimaj-Dardhë, Voskopojë, Voskopojë 2, Zëmlak- Qarr, Rungajë, administratorë të NJA, kryepleq të fshatrave që mund të preken nga objekti i këtij konsultimi.

- **Forma e konsultimit:** Takim publik

<p>Qëllimi i këshillimit publik</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Prezantimi çështjes/relacionit për konsultim publik 2. Evidentimi i procedurave që janë ndjekur deri tani për hartimin e planeve. 3. Prezantimi i përfitimeve të komunitetit nga projekti që propozohet. 4. Diskutim dhe mendime të publikut në lidhje me projekt vendimin që konsultohet
<p>Përshkrimi i çështjes që trajtohet në konsultim</p>	<p>Me financim nga Banka Botërore, e kontraktuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit e cila ka kontraktuar kompanitë Abkons dhe Oikon Croatia të cilat janë shpallur fituese për përgatitjen e disa planeve të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave të Bashkisë Korçë, të cilat janë selektuar nga Sektori i Pyjeve, aktualisht Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave, janë përgatitur gjashtë plane mbarështrimi të ekonomive pyjore “Panarit – Treskë”, “Përparimaj – Dardhë”, “Voskopojë”, “Voskopojë 2”, “Zëmlak – Qarr” dhe ekonomisë kullimore “Rungajë”.</p> <p>Pas realizimit planet e mbarështrimit të ekonomive pyjore dhe kullimore janë dorëzuar nga ana e kompanisë “Abkons dhe Oikon Croatia, në Bashkinë Korçë. Bazuar në nenin 54 të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 11, pika 2, shkronja “b” të ligjit nr. 57, datë 30.04.2020 “Për Pyjet”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 433, datë 08.06.2016, për “Transferimin në pronësi të bashkive, të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/ Bashkive”, në “Manualin e Planeve të Mbarshtrimit të Pyjeve dhe Kullotave” miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në Janar 2019, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Korçë të miratojë planet e mbarështrimit për ekonomitë pyjore Panarit – Treskë”, “Përparimaj – Dardhë”, “Voskopojë”, “Voskopojë 2”, “Zëmlak – Qarr” dhe ekonomisë kullimore “Rungajë”.</p>
<p>Pyetjet që ngre Këshilli ndaj publikut</p>	<p>Këshilli i Bashkisë është i interesuar të marrë opinionin e komunitetit në lidhje me çështjet si vijon :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. A jeni dakort me procedurën e ndjekur/ 2. Çfarë mendime/sugjerime keni në lidhje me planet e hartuara? 3. Tjetër

<p>Shpjegim i procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmarrë Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit</p>	<p>Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit i një Përmbledhje të Rekomandimeve dhe rezultateve të plota të takimit që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje; 2. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisionit të Komisionit të Buqësisë, Pyjeve, Menaxhimit të Ujërave, Mbrojtjes të Mjedisit dhe Biodiversiteit dhe çdo këshilltari të bashkisë; 3. Shqyrtimi nga ana e komisionit të Komisionit të Buqësisë, Pyjeve, Menaxhimit të Ujërave, Mbrojtjes të Mjedisit dhe Biodiversiteit (mbledhja e komisionit është e hapur për publikun sipas datave të parashikuara në kalendar) të cdo rekomandimi dhe të opinionit të Kryetarit të Bashkisë; 4. Marrja e vendimit për rekomandimet që do të përfshihen në projekt akin i cili kaloi në konsultim. 5. Diskutimi dhe miratimi i aktit në seancën e hapur të Mbledhjes së Këshillit; 6. Informimi i komunitetit, për marrjen në konsideratë të rekomandimeve ose për mosmarrjen në konsideratë dhe arsyet e mosmarrjes në konsideratë të tyre; 7. Publikimi i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit; 8. Njoftimi i administratës për aktin e miratuar; 9. Monitorimi i zbatimit të tij.
<p>Ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundshme</p>	<p>Opsionet e mundshme janë për t'u shqyrtuar nga ana e Këshillit :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Miratimi i planeve të mbarështimit për ekonomitë pyjore Panarit – Treskë”, “Përparimaj – Dardhë”, “Voskopojë”, “Voskopojë 2”, “Zëmbak – Qarr” dhe ekonomisë kullimore “Rungajë”. - Mos miratim i planeve të mbarështimit për ekonomitë pyjore Panarit – Treskë”, “Përparimaj – Dardhë”, “Voskopojë”, “Voskopojë 2”, “Zëmbak – Qarr” dhe ekonomisë kullimore “Rungajë”.
<p>Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve</p>	<p>Sugjerimet janë të mirëpritura deri më datë 20 qershor 2024, edhe në adresen e email: nacieva@yahoo.com dhe në faqen e FB të Këshillit Bashkiak Korçë https://www.facebook.com/KeshilliBashkiakKorce</p>

Data e publikimit	24.05.2024